


TERMAT E REFERENCËS:

Në hartimin e termave të referencës grupi i punës u mbështet në V.K.M Nr. 354, datë 11.05.2016 “PËR MIRATIMIN E MANUALIT TË TARIFAVE PËR SHËRBIME NË PLANIFIKIM TERRITORI, PROJEKTIM, MBIKQYRJE DHE KOLAUDIM”.

Godinat që do t’i bëhet riforcimi në këtë investim janë:

1. PALLATI N ME KOD GIS 5709-5711



Vendodhja e Objektivit

Objekti ndodhet ne rrugen “Pelikani”, “Bashkia DURRES” gjeresi dhe gjatesi gjeografike 41.311524 N dhe 19.485247 E sikurse tregohet edhe ne pamjet e mesiperme.

Në bazë të Udhëzimit Nr.1, datë 16.06.2011, “Për disa ndryshime në udhëzimin Nr.3, datë 15.02.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar:

Mbikëqyrja e punimeve kryhet nga persona fizikë dhe juridikë të pajisur me certifikatë personale përkatëse. Mbikëqyrja e punimeve për objekte që ndërtohen me financim publik, emërohet nga investitori pas zgjedhjes me prokurim në përputhje me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Koha e mbikëqyrjes së punimeve lidhet me kohën e zgjatjes së punimeve dhe fillon nga data e lidhjes së kontratës me firmën zbatuese.

Në përfundim të punës mbikëqyrësi i punimeve dorëzon me proces verbal te investitori dokumentacionin teknik të mbajtur gjatë zbatimit të punimeve.